



**Hapet Thirrja për mobilitete (bursa) studentësh të UPT-së  
në kuadër të Marrëveshjes KA1  
në University of Westminster, Angli**

Në kuadër të Marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, **Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit**, në University of Westminster.

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Bachelor për studime.

**Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- **Bachelor** (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Bachelor, në Universitetin Politeknik të Tiranës, **Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit** dhe të kenë përfunduar një vit studimi.)

**Kohëzgjatja e bursave:**

- 1 semestër (shtator 2022 – janar 2023), ose një vit i plotë akademik (shtator 2022 - shtator 2023). Semestri ka 30 kredite. Studentët janë në gjendje të studiojnë deri në një maksimum prej 60 kreditesh/30 ECTS për semester.

**Fusha e studimit:**

- Computer Science

**Numri total i studentëve:** 3 studentë

**Dokumentat e nevojshme për aplikim:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit, në shqip dhe në anglisht, i noterizuar;
- Listë notash e studimeve Bachelor, deri në momentin e aplikimit. (Mesatarja e notave duhet mbi 7. (Të vërtetohet me listë notash.) Në shqip dhe në anglisht, e noterizuar;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Certifikatë e gjuhës së huaj\*;

*\*Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar është **B2**. (Preferohet niveli C1, IELTS.) Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar, duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në University of Westminster, lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvillonit lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.*

Informacioni se çfarë mund të marrin studentët në lidhje me modulet, si dhe me:

- Kalendarin akademik;
- Opsionet e akomodimit;
- Informacionin e koordinatorit akademik;
- Si të aplikoni;
- Si të zgjidhni modulet;



- Orientimin para mbërritjes;
- Informacionin "Pyetjet e bëra më shpesh"

gjendet në link-un:

<https://www.westminster.ac.uk/international/student-exchanges/modules-and-credit/choosing-your-modules>

Studentët, përpara se të aplikojnë, janë të lutur të njihen me informacionin, në linkun e mëposhtëm:

<https://www.westminster.ac.uk/international/student-exchanges/how-to-apply>

*Studentët që i përkasin familjeve me të ardhura vjetore ekuivalente ose më pak se 25,000 £, kanë të drejtë të përfitojnë një grant shtesë.*

*Për këtë, studenti duhet të sigurojë:*

- Vërtetim nga punëdhënësit e prindërve, që konfirmon pagat e tyre;
- Kopjet e fletëpagesave të prindërve të tyre.

*Ky informacion kërkohet më vonë se faza e nominimit.*

Dorëzimi i dokumentave të nevojshme për aplikim kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT, **brenda datës 25 Mars 2022.**

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në e-mail: [abeqo@upt.al](mailto:abeqo@upt.al) dhe [rkodra@upt.al](mailto:rkodra@upt.al).